



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2023:002208

Datë: 25.09.2024

Numri i dokumentit: 06204649

**C.nr.105/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtarin Binak Duqi, dhe bashkëpunëtorin profesional Mensur Avdullahu, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: 1.Sh. G. – A. me nr. Personal ..., 2. S. E. me nr. Personal ..., 3. K. M. me nr. Personal ..., 4. V. G. me nr. Personal ... dhe 5. E. Z. me numër personal ... të gjithë nga P., e të cilët i përfaqëson sipas autorizimit av. V. B. – M. nga P. adresa Rr: “N. K.”, kompleksi L., kati ..., nr. ..., kundër të paditurës Komuna e Podujevës, Drejtoria Komunale e Arsimit nga P., Rruga “N. G.” pn., me objekt kontesti: Kompensimin e Inflacionit në pagën bazë, me vlerë të kontestit **3,491.66 Euro**, jashtë seance me dt.24.09.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**- pa shqyrtim kryesor të çështjes -**

**I. APROVOHET** pjesërisht kërkesëpadia e paditësve 1.Sh. G. – A., 2. S. E., 3. K. M., 4. V. G. dhe 5. E. Z. nga P., **si e bazuar**, dhe:

**II. DETYROHET** e paditura Komuna e Podujevës, Drejtoria Komunale e Arsimit në P., që paditësve t’ua kompensojë shumat në emër të Inflacionit në pagën bazë dhe atë si ne vijim:

1. Paditëses Sh. G. – A.

- Për periudhën Janar-Dhjetor 2020, për 0.2% x 421.00 € (paga bazë) = 0.84 x 12 muaj=10.08€.
- Për periudhën Prill-Dhjetor 2021, për 3.4% x 421.00 € (paga bazë) = 14.31 x 12 muaj=171.72€.
- Për periudhën Janar-Nëntor 2022, për 11.60% x 421.00 € (paga bazë) =48.83x11muaj = 537.13€.

Në total shuma e aprovuar në emër të kompensimit të inflacionit prej **718.93 Eurove**.

2. Paditëses S. E.

- Për periudhën Janar-Dhjetor 2020, për 0.2% x 254.52 € (paga bazë) = 0.50 x 12 muaj=6.00€.
- Për periudhën Prill-Dhjetor 2021, për 3.4% x 254.52 € (paga bazë) =8.64 x 12 muaj=103.68€.
- Për periudhën Janar-Nëntor 2022, për 11.60% x 254.52 € (paga bazë) =29.52x11muaj = 324.72€.

Në total shuma e aprovuar në emër të kompensimit të inflacionit prej **434.40 Eurove**

### 3. Padi tëses K. M.

- Për periudhën Janar-Dhjetor 2020, për 0.2% x 242.40 € (paga bazë) = 0.48 x 12 muaj=5.76€.
- Për periudhën Prill-Dhjetor 2021, për 3.4% x 242.40 € (paga bazë) = 8.24 x 12 muaj=98.88€.
- Për periudhën Janar-Nëntor 2022, për 11.60% x 242.40 € (paga bazë) =28.11x11muaj=309.21€.

Në total shuma e aprovuar në emër të kompensimit të inflacionit prej **413.85 Eurove**

### 4. Padi tëses V. G.

- Për periudhën Janar-Dhjetor 2020, për 0.2% x 421.00 € (paga bazë) = 0.84 x 12 muaj=10.08€.
- Për periudhën Prill-Dhjetor 2021, për 3.4% x 421.00 € (paga bazë) = 14.31 x 12 muaj=171.72€.
- Për periudhën Janar-Nëntor 2022, për 11.60% x 421.00 € (paga bazë) =48.83x11muaj = 537.13€.

Në total shuma e aprovuar në emër të kompensimit të inflacionit prej **718.93 Eurove**

### 5. Padi tësit E. Z.

- Për periudhën Janar-Dhjetor 2020, për 0.2% x 242.40 € (paga bazë) = 0.48 x 12 muaj=5.76€.
- Për periudhën Prill-Dhjetor 2021, për 3.4% x 242.40 € (paga bazë) = 8.24 x 12 muaj=98.88€.
- Për periudhën Janar-Nëntor 2022, për 11.60% x 242.40 € (paga bazë) =28.11x11muaj=309.21€.

Në total shuma e aprovuar në emër të kompensimit të inflacionit prej **413.85 Eurove**

**III.** Refuzohet kërkesa e padi tëseve 1. Sh. G. – A. dhe 2. V. G. përtej shumës së aprovuar 718.93 Eurove, dhe atë për shumën tjetër të kërkuar prej 136.52 € për secilin padi tës veç e veç si e pabazuar (parashkruar), padi tësve K. M. dhe E. Z. i refuzohet kërkesa përtej shumës së aprovuar 491.09 € dhe atë për shumën tjetër të kërkuar prej 77.24 € për secilin padi tës veç e veç si e pabazuar (parashkruar), si dhe padi tëses S. E. i refuzohet kërkesa përtej shumës së aprovuar 434.40 €, dhe atë në shumën tjetër të kërkuar prej 364.18 € si e pabazuar dhe e parashkruar, shuma e përgjithshme e refuzuar për të gjithë padi tësit 791.70 €.

**IV. DETYROHET** e paditura që shumat e aprovuara, secilit padi tës veç e veç t'ia paguaj me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar të llogaritet nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 382.00 Euro, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarimit.

**V. DETYROHEN** padi tësit 1.Sh. G.- A., 2. S. E., 3. K. M., 4. V. G. dhe 5. E. Z., që në emër të taksës gjyqësore shtese për padi të paguajnë në mënyrë solidare shumën prej 20.00 €, në llogarinë e gjykatës, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

**VI.** Refuzohet kërkesa e padi tësve për pagesën e kamatës ligjore prej 8 % në vit, që ajo të paguhet nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive si e pabazuar.

## A r s y e t i m

Paditësit, përmes te autorizuarës të tyre, me datë 05.01.2023, në këtë gjykatë ka paraqitur padi kundër të paditurës për kompensimin në emër të kërkesave të përshkruara dhe shumën e përgjithshme, si në pjesën hyrëse të këtij aktgjykimi.

Ka shtuar se paditësit janë apo kane qene në marrëdhënie të rregullt pune apo ka qenë te e paditura si punëtor arsimit në SH.F.M.U. “Xh. R.” në P., dhe se e paditura përkundër obligimeve, përkatësisht fitimit të të drejtave të cilat rrjedhin nga Kontrata kolektive e Arsimit në Kosovë, e konkretisht nenit 35 paragrafit 10 të saj, e paditura përkundër obligimit që rrjedh nga kjo bazë ligjore nuk ka bërë kompensimin e inflacionit në emër të kërkesave të paditësve sipas Entit te Statistikave të Kosovës, ashtu siç janë precizuar edhe ne parashtrësën e datës 05.09.2024.

Andaj, i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj padinë dhe kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar dhe ta detyroj të paditurën që të bëjë kompensimin e shumave së precizuara në emër të kërkesave të lartcekura.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi te datës 11.09.2024, i ka pohuar faktet vendimtare duke theksuar se e konteston kërkesëpadinë e paditësit, për kompensimin në emër të kërkesave të tij. Ka theksuar se padia nuk ka bazë juridike, ngase me dispozitat kalimtare të kontratës kolektive në fuqi nga dt.18.04.2017 dhe 22.01.2021, në nenin 46 të saj është paraparë se MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht për t’i informuar dhe ndihmuar Komunat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe koston financiare për pagesën e obligimeve që rrjedhin nga neni 35, andaj e paditura nuk ka buxhet për kryerjen e obligimeve ndaj punëtorëve. Ka shtuar se kjo kontratë kolektive sipas nenit 90.5 të ligjit të punës, vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me kontratën kolektive, e në rastin konkret e paditura nuk është nënshkruese kësaj kontrate.

Më tej ka shtuar se kemi te bëjmë me parashkrim te kërkesës se paditësve dhe duhet ti hiqen 13 muaj për shkak te parashkrimit.

Andaj, i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj si të pabazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 152 i Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se: *“po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundëjt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim”*, lidhur me nenet 143 dhe 147 të të njëjtit ligj, nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij, dhe ka gjetur se në këtë çështje juridike kontestuese plotësohen kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor.

Gjykata, duke pasur parasysh faktin se i padituri i ka pohuar faktet vendimtare, përkundëjt kontestimit të kërkesëpadisë, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor dhe administrimi i provave për faktet e pohuara.

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se nuk është kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura me disa vite përvojë pune, po ashtu nuk është kontestuese se e paditura nuk i ka paguar paditësës kompensimin në emër të kërkesave të tij, pasi që një gjë e tillë nuk kontestohet nga palët, kjo vërtetohet dhe me provat materiale në shkresat e lëndës.

Andaj, gjykata, komform nenit 152 dhe 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke iu referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e dt.18.04.2017, konkretisht nenin 35 par.10 të njëjtit nen ku është përcaktuar se: *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë.”*, por këtë nuk e ka bërë e paditura edhe pse ka qenë e obliguar ta bëjë këtë.

Po ashtu kjo është e rregulluar me Ligjin nr.03/L-212 e Punës, sipas nenit 90 par.4 të tij ku thuhet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhe të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se 3 ( tri) vjet.”*, siç është dhe me këtë Kontratë (e cila ka qenë në fuqi komform nenit 45 par.2 të saj, deri me datën 22.01.2021), e që kjo çështje është rregulluar njëjtë dhe me dispozitat e nenit 35 par.10 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë në fuqi nga data 22.01.2021 të cilat gjejnë zbatim në rastin e paditësit, si dhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës GJ.A-Su.A.214/2023 të datës 05.10.2023, i cili në pikën II, ka përcaktuar se: *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, Sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve.”*, por këtë nuk e ka bërë e paditura edhe pse ka qenë e obliguar ta bëjë këtë.

Gjykata lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë se paditësve vendosi duke u bazuar në Kontratën e Punës Nr. protokollin ... të datës 01.09.2012 si dhe listë e pagave e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës nga e cila vërtetohet se paditësja Sh. G. – A. ka realizuar page baze ne vlere prej 421.00 € të dya këto lëshuar për paditësen Sh. G. – A., Kontrate Pune Nr. Protokollin ... e datës 01.02.2021, 05/1376 e datës 03.09.2018, 05/1376 e datës 01.09.2020, 05/1376 e datës 02.09.2019, 05/1376 e datës 01.10.2017 si dhe listë e pagave e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës nga e cila vërtetohet se paditësja S. E. ka realizuar page baze me koeficient 4.2 e që i bie paga bazë 254.52€, te gjitha këto lëshuar për paditësen S. E., Kontrate Pune Nr. Protokollin ... e datës 01.09.2020, 05 nr. ... e datës 01.09.2019 si dhe listë e pagave e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës nga e cila vërtetohet se paditësja K. M. ka realizuar page baze me koeficient 4 e që i bie paga 242.40 €, te gjitha këto lëshuar për paditësen K. M., Kontrate Pune Nr. Protokollin ... e datës 01.09.2021 si dhe listë e pagave e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës nga e cila vërtetohet se paditësja V. G. ka realizuar page baze ne vlere prej 421.00 € te dya këto lëshuar për paditësen V. G., Kontratën e Punës Nr. protokollin ... nr.... të datës 01.09.2021 si dhe listë e pagave e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës nga e cila vërtetohet se paditësi E. Z. ka realizuar page baze me koeficient 4 e që i bie paga 242.40 €, të dya këto lëshuar për paditësin E. Z., si dhe te dhënat nga Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit e për periudhën Janar 2010 – Maj 2022, me ç ‘rast kemi të bëjmë me dokumente publike të cilat kanë fuqi të plotë provuese, e që në anën tjetër e paditura nuk i ka rrëzuar me prova materiale fuqinë provuese të këtyre dokumenteve, e gjithë kjo dhe bazuar në dispozitën e lart cituar të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, konkretisht nenit 35 par.10 të saj dhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës GJ.A-Su.A.214/2023 të datës 05.10.2023.

Ju refuzua kërkesa e paditësve Sh. G. dhe V. G. përtej shumës së aprovuar në shumën si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë ne shumën prej 136.52 Eurove (secilit paditës veç e veç) si e pa bazuar (parashkruar), në emër të kompensimit te Inflacionit dhe atë për periudhën kohore nga data 01.01.2019 deri me 31.12.2019, për 12 muaj, meqë gjykata në kuptim të rrethanave të konstatuara me lart dhe duke e vlerësuar prapësimin e të paditurës në lidhje me parashkrimin e kërkesës, gjeti se kërkesa për këtë periudhë është e parashkruar. Kjo komform

dispozitës së nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, (e cila dispozitë ka karakterin prekluziv) ku lidhur me kërkesat në para nga marrëdhënia e punës është paraparë afati i parashkrimit ashtu që është përcaktuar se: *”Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.”*, i cili afat në rastin konkret ka kaluar para se të jetë ngritur padia dhe atë nga data e hyrjes në fuqi të Kontratës Kolektive dt.18.04.2017 deri në ngritjen e padisë 05.01.2023, kanë kaluar mbi 3 vite me çka është parashkruar dhe kërkesa për realizimin e shtesës mujore në bazë të Inflacionit për këtë periudhë, komform dispozitave të lart cituara.

Ju refuzua kërkesa e paditësve K. M. dhe E. Z. përtej shumës së aprovuar në shumën si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë ne shumen prej 77.24 Eurove (secilit paditës veç e veç) si e pa bazuar (parashkruar), në emër të kompensimit të Inflacionit dhe atë për periudhën kohore nga data 01.01.2019 deri me 31.12.2019, për 12 muaj, meqë gjykata në kuptim të rrethanave të konstatuara me lart dhe duke e vlerësuar prapësimin e të paditurës në lidhje me parashkrimin e kërkesës, gjeti se kërkesa për këtë periudhë është e parashkruar. Kjo komform dispozitës së nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, (e cila dispozitë ka karakterin prekluziv) ku lidhur me kërkesat në para nga marrëdhënia e punës është paraparë afati i parashkrimit ashtu që është përcaktuar se: *”Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.”*, i cili afat në rastin konkret ka kaluar para se të jetë ngritur padia dhe atë nga data e hyrjes në fuqi të Kontratës Kolektive dt.18.04.2017 deri në ngritjen e padisë 05.01.2023, kanë kaluar mbi 3 vite me çka është parashkruar dhe kërkesa për realizimin e shtesës mujore në bazë të Inflacionit për këtë periudhë, komform dispozitave të lart cituara.

Ndërsa Ju refuzua kërkesa e paditëses S. E. përtej shumës së aprovuar në shumën si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë ne shumen totale prej 364.18 Eurove si e pa bazuar dhe e (parashkruar), në emër të kompensimit të Inflacionit dhe atë nga shuma totale pjesa prej 136.32 € iu refuzua për shkak të parashkrimit dhe atë për periudhën kohore nga data 01.01.2019 deri me 31.12.2019, për 12 muaj, meqë gjykata në kuptim të rrethanave të konstatuara me lart dhe duke e vlerësuar prapësimin e të paditurës në lidhje me parashkrimin e kërkesës, gjeti se kërkesa për këtë periudhë është e parashkruar. Kjo komform dispozitës së nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, (e cila dispozitë ka karakterin prekluziv) ku lidhur me kërkesat në para nga marrëdhënia e punës është paraparë afati i parashkrimit ashtu që është përcaktuar se: *”Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.”*, i cili afat në rastin konkret ka kaluar para se të jetë ngritur padia dhe atë nga data e hyrjes në fuqi të Kontratës Kolektive dt.18.04.2017 deri në ngritjen e padisë 05.01.2023, kanë kaluar mbi 3 vite me çka është parashkruar dhe kërkesa për realizimin e shtesës mujore në bazë të Inflacionit për këtë periudhë, komform dispozitave të lart cituara.

Ndërsa pjesa e mbetur ne shumen prej 227.86 iu refuzua si e pabazuar për faktin se paditësja llogaritjen e inflacionit e ka bërë me pagën bazë 421.00 €, e që nga lista e pagave të dorëzuar nga paditësja gjykata vërteton se e njëjta ka realizuar page baze me koeficient 4.2 të llogaritur me 60.60 e që i bie të jete paga baze e paditëses 254.52 €, andaj iu refuzua kërkesa e lartcekur si e pabazuar.

Gjykata i konsideron si të papranueshme dhe të pabazuara pretendimet dhe kundërshtimet e të paditurës se ajo nuk ka asnjë obligim ndaj paditësit me arsyetim se nuk ka buxhet për të bërë këto pagesa në emër të kërkesave të paditësit, se nuk është nënshkruese e kontratës, për çka edhe i ka propozuar gjykatës që padia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Kamatëvonesa është vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 382 të Ligji Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e palëve dhe provat tjera të ofruara, por vlerësoi se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të çështjes kontestimore si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449, 450, 452 dhe 453.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Udhëzimit Administrativ të KGJK-së nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore si dhe Rregullores për Tarifat e Avokatëve e Odës së Avokatëve të Kosovës (2017). Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara u referohet për përpilimin e padisë shuma prej 312.00 euro, për parashtresën për precizimin e kërkesëpadisë shuma prej 50.00 €, si dhe taksave gjyqësore të paguara për padi në shumë prej 20.00 eurove, apo gjithsejtë shuma prej 382.00 €, duke marrë për bazë vetëm ato shpenzime të cilat kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjykatë.

Gjykata lidhur me detyrimin e pagesës së taksës shtese për padinë e ushtruar në gjykatë, u mor konform dispozitave të nenit 253.1 dhe 4 të LPK –se si dhe nenit 12.1 të Udhëzimit Administrativ të KGJK –se, nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave gjyqësore, duke detyruar paditësit që në emër të taksës gjyqësore shtese për padi të paguajnë shumën prej 20.00 euro, në bazë të vlerës së kërkesëpadisë të saktësuar me parashtresën e dt. 05.09.2024, meqë gjykata nuk ka dëshmi se është paguar nga paditësit, ngase me rastin e dorëzimit të padisë në gjykatë është paguar vetëm taksa gjyqësore në shumën prej 20.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e cekura më lartë.

**Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.105/2023, me datën 24.09.2024**

**Gjyqtari :**  
Binak Duqi

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.